

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, -Departamenti i Përgjithshëm-** përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi në lëndën penale kundër të pandehurit R. I nga Gj me mbrojtësin me autorizim av.B. I nga Gj, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.264/2016, të datës 08.02.2016, të cilin e përfaqëson Prokurori Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit, mbi pranimin e marrëveshjes së fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit të pandehurit dhe mbrojtësit të ti dhe të dëmtuarit, më datën 18.05.2017, mori dhe në prezencë të palëve shpalli këtë,

## **A K T G J Y K I M**

I Pandehuri R.I, nga i ati E e ëma T, e lindur M, i lindur më dt..., në Gj, ku edhe jeton ka të kryer shkollën mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa punë, shqiptar, shtetas e R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëheqet procedurë për veprë tjetër penale.

### **Ë s h t ë f a j t o r**

Sepse më datë 03.02.2016, rreth orës 18:30 minuta, në shtëpinë e tyre të përbashkët familjare në Gj, për shkak të mosmarrëveshjeve dhe dhunës së vazhdueshme familjare, i pandehuri R. I, me dashje e sulmon babain e vet-tani të dëmtuarin E.I në atë mënyrë që i njejt duke u paraqitur nervoz dhe në shenjë revolte pa ndonjë pretekst dhe në prezencë të nënës së vet, e sulmon babain e vet-tani të dëmtuarin E.I, duke e goditur të njejtin me shkelëm në pjesë të ndryshme të trupit, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta, me dashje, pa pëlqimin e tij, e ka sulmuar dhe ka përdorur forcën fizike ndaj të dëmtuarit të sipërshënuar,

-me çka ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

Prandaj gjykata duke iu referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit Ramadan Ibrahim, në bazë të neneve 4, 41, 46, 73 dhe 75 të KPRK-s dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s.

### **DENIM ME KUSHT**

Të akuzuarit R. I, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 180 (njëqindë e tetëdhjetë), i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjilan.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 4 të KPPRK-s, i akuzuari R. I Lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.

### **A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njejt ka kryer veprën penale lëndore të përshkruar më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shpresor dhe ka propozuar që pas mbajtjes së séances gjyqësore dhe shtjellimit të provave të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta denoj me dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i shtetit Kujtesa Fazliu deklaron: Pas negociimit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, më dt.07.04.2017, kemi arritur marrëveshje, mbi pranimin e fajësisë me të

pandehurin, ku i njëjti është pajtuar që të pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, dhe atë gjithnjë në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësin e tij. Prandaj, bazuar në këtë kërkojmë nga gjykata që konform nenit 233 par.21 të KP që këtë marveshje dhe dënimin ta aprovojë.

I dëmtuari deklaron: pajtohem me marrëveshjen e arritur mes prokurorisë dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij.

Mbrojtësi i të pandehurit me autorizim av. ..deklaron: është e vërtetë që me dt. 07.04.2017, me prokurorin e shtetit kemi negociuar marveshjen dhe jemi pajtuar bashkarisht duke marrë pjesë edhe i pandehuri për të gjitha pikat të cilat janë të cekura në marveshje, andaj gjykatës i propozoj që këtë marveshje dhe dënimin ta aprovojë.

I pandehuri, deklaron: e mbështes në tërësi deklaratën e mbrojtësit tim, dhe deklaron se nuk ka tjetër se qka të shtoj.

Marveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet duke bërë propozim për marveshjen e pranimit të fajësisë duke e njoftuar të akuzuarin me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se i pandehuri ka bërë marveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njehta marveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vëhet në barrë dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë përjashtim si në nenin 248 të KPPRK.

Në seancën për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës i pandehuri dhe mbrojtësit i tij janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që ti shqiptohet denim burg në kohëzgjatje prej 180 (njëqindë e tetëdhjetë), i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjilan.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 4 të KPPRK-s, i akuzuari Lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.

Përfaqësuesi i akuzës, i pandehuri dhe mbrojtësi i të pandehurit me autorizim kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr. 249/16 të datës 18.05.2017**

**Sek. Juridike,**  
**Igballe Azemi d.v**

**Gjykatësi i vetëm gjykues,**  
**Behar Ymeri d.v**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky aktgjykim është i plotëfuqishëm ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 233 par.12 pika 1, dhe pika 3.të KPPRK-ës.

Gjykatësi i vetëm gjykues komunikoi këtë,

### A k t v e n d i m

I Pandehuri Ramadan Ibrahim, nga i ati Ekrem, e ëma Tevide, e lindur Miftari, i lindur më dt.15.02.1995, në Gjilan, ku edhe jeton Rr."Vëllezërit Frashëri" nr.154, ka të kryer shkollën mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa punë, shqiptar, shtetas e R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëheqet procedurë për vepër tjetër penale.

### Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më datë 03.02.2016, rreth orës 18:30 minuta, në shtëpinë e tyre të përbashkët familjare në Gjilan, për shkak të mosmarrëveshjeve dhe dhunës së vazhdueshme familjare, i pandehuri Ramadan Ibrahim, me dashje e sulmon babain e vet-tani të dëmtuarin Ekrem Ibrahim, në atë mënyrë që i njejt duke u paraqitur nervoz dhe në shenjë revolte pa ndonjë pretekst dhe në prezencë të nënës së vet, e sulmon babain e vet-tani të dëmtuarin Ekrem Ibrahim, duke e goditur të njejtin me shkelëm në pjesë të ndryshme të trupit, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e veta, me dashje, pa pëlqimin e tij, e ka sulmuar dhe ka përdorur forcën fizike ndaj të dëmtuarit të sipërshtënuar,

-me çka ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

Prandaj gjykata duke iu referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit Ramadan Ibrahim, në bazë të neneve 4, 41, 46, 73 dhe 75 të KPRK-s dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s.

### DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit Ramadan Ibrahim, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 180 (njëqindë e tetëdhjetë), i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjilan.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 4 të KPPRK-s, i akuzuari Ramadan Ibrahim Lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.

Përfundoi në ora 14:05 min.

### V ë r t e t o j n ë:

Sekretarja juridike

Gjykatësi i vetëm gjykues